LIGJ
Nr. 22/2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 97/2013, "PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 102, pika 3 riformulohet si më poshtë:

"3. Emëron Drejtorin e Përgjithshëm me tre të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të tij në votimin e parë, në votimin e dytë ose në votimin e tretë. Nëse në votimin e parë nuk arrihet shumica prej tre të pestave, KDRTSH-ja cakton menjëherë datën e kryerjes së votimit të dytë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të parë. Në rast se edhe në votimin e dytë nuk arrihet shumica prej tre të pestave, KDRTSH-ja cakton menjëherë datën e kryerjes së votimit të tretë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të dytë. Në rast se edhe në votimin e tretë nuk arrihet shumica prej tre të pestave, KDRTSH-ja cakton menjëherë datën e kryerjes së votimit të katërt, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të tretë. Në votimin e katërt dhe të pestë KDRTSH-ja vendos për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm me më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Votimi i pestë kryhet në rastin kur në votimin e katërt asnjë kandidat nuk ka siguruar shumicën e kërkuar të votave dhe zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të katërt. Votimi i pestë zhvillohet vetëm midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votim caktohet me short. Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, KDRTSH-ja shpërndahet.".

Neni 2

Në nenin 102, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. Liron Drejtorin e Përgjithshëm me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të tij".

Neni 3
Dispozita kalimtare

Dispozitat e statutit të RTSH-së për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 4

Në nenin 99, pika 6, hiqen fjalët "emërimin ose".

Neni 5

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për zgjedhjet që janë duke u zhvilluar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 10.3.2016